



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR  
MË 20 MAJ 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA ODRŽANE  
20. MAJA 2008. GODINE**

**Maj – Maja  
2008**

## **R e n d i i d i t ë s**

### **1. Shqyrtimi i parë i Grupit të tretë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:**

- 1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë,
- 1.3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
- 1.4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror,
- 1.5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil, dhe
- 1.6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

## **D n e v n i r e d:**

### **2. Prvo razmatranje treće grupe nacrtu zakona iz Predloga Martti Ahtisaarija, po posebnom postupku:**

- 1.1. Provo razmatranje Nacrt zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo,
- 1.2. Provo razmatranje Nacrt zakona o Obaveštajnoj agenciji Kosova,
- 1.3. Provo razmatranje Nacrt zakona o Agenciji za privatizaciju,
- 1.4. Provo razmatranje Nacrt zakona o integrisanom upravljanju i kontroli državne granice,
- 1.5. Provo razmatranje Nacrt zakona o azilu, i
- 1.6. Provo razmatranje Nacrt zakona o službenim praznicima u Republici Kosova.

## **A g e n d a:**

### **1. First reading of the third group of the Draft Laws from the Martti Ahtisaari's proposal, based on the Special procedure:**

- 1.1. First reading of the Draft Law on Education in the Municipalities of the Republic of Kosovo,
- 1.2. First reading of the Draft Law on the Kosovo Intelligence Agency,
- 1.3. First reading of the Draft Law on the Kosovo Privatization Agency,
- 1.4. First reading of the Draft Law on Integrated Management and Control of the State Border,
- 1.5. First reading of the Draft Law on Asylum, and
- 1.6. First reading of the Draft Law on Official Holidays in Republic of Kosovo.

## TRANSKRIPT

### NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 20 MAJ 2008

Seanca plenare, filloi punën në ora 10,00.

Seancën plenare e kryesoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

**KRYETARI I KUVENDIT:** Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës!

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 99 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Rendi i ditës, së bashku me materialet, iu është shpërndarë deputetëve.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

#### **- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 19 maj 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij, në parim, konform Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zoti Enver Hoxhaj, që në emër të Qeverisë para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

Zoti ministër, vetëm një moment. Në fillim të seancës plenare, ky propozim i rendit të ditës konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 anëtarë të Kuvendit i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament për rend të ditës, i cili vihet në votim.

Meqë nuk kemi pasur kërkesë me shkrim lidhur me këtë, ministri le ta vazhdojë diskutimin e tij.

(Ndërhyrje e deputetit)

Po, lexoje vendimin! Vazhdo, ministër!

**MINISTRI ENVER HOXHAI:** I nderuar, zoti Kryetar,

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,  
Më lejoni që në pika të shkurtra ta prezantoj Ligjin për arsim në komunat e Republikës së Kosovës.

Qëllimi themelor i këtij ligji është rregullimi, por në të njëjtën kohë edhe ofrimi i arsimit në nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm, të arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Duke rregulluar çështjet që kanë të bëjnë me arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, Ligji po ashtu rregullon edhe kompetencat dhe përgjegjësitë që i ka Ministria e Arsimit në fushën e hartimit të politikave dhe të legjislacionit në fushën e organizimit të arsimit formal dhe joformal, në fushën e rregullimit të cilësisë në arsim dhe të monitorimit të arsimit, e po ashtu edhe në fushën e ndërlidhjes së arsimit, të zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit social.

Të nderuar deputetë,  
Pjesa më vitale e Ligjit është se ky ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me kompetencat e komunave dhe sidomos me kompetencat e zgjeruara të komunave, ku ndër të tjera hyn edhe çështja e regjistrimit dhe të pranimit të nxënësve, pranimi i personelit mësimor, i mësimdhënësve dhe i personelit tjetër administrativ në shkolla, çështja e zgjedhjes së menaxhmentit shkollor, të drejtorëve dhe të zëvendësdrejtorëve, çështjet e shëndetit të nxënësve dhe çështjet e tjera që ndërlidhen me arsimin fillor dhe të mesëm.

Përveç kësaj, ky ligj rregullon edhe përgjegjësitë administrative që kanë komunat në ofrimin e arsimit fillor e të mesëm dhe po ashtu rregullon edhe kompetencat të cilat rrjedhin nga burimet e financimit.

Ndër çështjet e tjera që rregullon ky ligj, të cilat janë të cekura, janë edhe çështjet e arsimit në gjuhën serbe, ku ndër të tjera rregullohet edhe çështja e organizimit të mësimin në gjuhën serbe, të plan-programeve shkollore, të kompetencave të zgjeruara për komunën e Mitrovicës së veriut, si dhe çështjet e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Ligji ka 6 kapituj, ka 17 nene, buron nga Pakoja e Ahtisarit dhe të njëjtën kohë është në përputhje me legjislacionin evropian. Prandaj, në këtë drejtim, ju kisha ftuar ta votoni këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Sipas radhës, nëse kryetari i grupit ad-hoc nuk e do fjalën, atëherë ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Ramë Buja.

Më falni, të Partisë Demokratike të Kosovës!

RAMË BUJA: Zoti Kryetar, konsideroj se duhet të kërkoj falje për këtë gjë!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra,

Në bazë të mundësisë së kohës së shkurtër që kemi pasur për ta shqyrtuar këtë projektligj, ne si Grup Parlamentar kemi vendosur që në parim sot ta aprovojmë për të parë pastaj grupi ad-hoc se çfarë do të bëhet nesër në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka tash kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Lutfi Haziri. Si duket, në vend të tij, Agim Veliu, do ta marrë fjalën! Urdhëroni!

AGIM VELIU: Faleminderit, Kryetar!

Me sa më kujtohet, nuk ka qenë kërkesë që të ketë ligj të veçantë për arsimin lokal. Kjo materie është thënë se do të rregullohet me ligjet ekzistuese dhe me amendimin e tyre. Kujtoj se kërkesat e dokumentit të Ahtisarit kanë mund të implementohen në ligjet ekzistuese si në atë të arsimit parauniversitar, ashtu edhe në arsimin e lartë.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i LDK-së pajtohet që ky ligj të aprovohet në parim, kurse vërejtjet do të paraqiten në Komisionin ad-hoc. Si vërejtje ne kemi rreth plan-programeve ose rreth disa kompetencave tjera, që do t'i paraqesim në grup. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, do të duhej Ibrahim Makolli, por si duket e ka harruar kartelën dhe ai mungon. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar! Sikur edhe dy kolegët paraprakisht, pajtohemi që ky ligj të votohet në parim dhe të shohim pastaj çfarë mund të përmirësojmë në Komisionin ad-hoc. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, e ka fjalën shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah në parim, ndërsa në Komisionin ad-hoc do të shikojmë, do ta japim kontributin tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, fjalën e ka shefi Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zotëri Kryeministër, zëvendëskryeministra e ministra,

Edhe ne, sikur të gjithë parafolësit, pajtohemi që ky ligj të kalojë për më tutje.

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, Grupi Parlamentar i SLS-së, Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovane kolege poslanici,

Uvaženi predsjedniče,

Poštovani u Vladinom kabinetu,

Želim da kažem da će Samostalna liberalna stranka u načelu podržati ulaženje ovog zakona u Skupštinsku proceduru, međutim moram da istaknem jednu stvar da, s obzirom da se radi o suštinski bitnom zakonu po zaštitu interesa Srpske zajednice, da moram da uložim primedbu u ime članova Parlamentarne grupe Samostalne liberalne stranke da je materijal za ove zakone podeljen tek jutros poslanicima, tako da nismo imali vremena da se spremimo. No, bez obzira na to, mi ćemo podržati usvajanje ovog zakona, a na ad-hoc komisiji ćemo se truditi da neke stvari implementiramo kako bi poboljšali zaštitu interesa Srpske zajednice. S obzirom da se radi o Zakonu za obrazovanje na opštinskim nivoima a, kao što znamo, nisu sve srpske sredine na Kosovu obuhvaćene decentralizacijom, tako da će neke ostati i u opštinama gde neće biti možda predstavnika u vlastima Srpske zajednice. Hvala!

KRYETARI: Në vazhdim, kërkoj që deputetët të deklarojnë lidhur me miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 88 deputetë.

Pyes deputetët, a ka ndonjë që nuk e kanë kartelën me veti? Nuk ka. Faleminderit!

Konstatohet se me 68 vota “për”, 2 vota “kundër”, 4 abstenime – u miratua Projektligji, në parim.

Në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’i paraqet Kuvendit raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 19 maj 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij, në parim, konform Vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, të prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuar, Kryetar i Kuvendit,

I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Deputetë dhe ministra të nderuar,

Sot para jush paraqes Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Projektligj i cili parasheh themelimin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, si Agjenci për Siguri dhe Inteligjencë të Kosovës.

Mendoj se është fare e qartë nevoja për informacion me kohë dhe të saktë për Kosovën dhe funksionimin e duhur të institucioneve të saj. Inteligjenca dhe kundërinteligjenca janë mjet i fuqishëm dhe i domosdoshëm për të parandaluar çdo lloj kërcënimi nga brenda dhe

nga jashtë: terrorizmin ndërkombëtar apo vendor; prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve; krimin e organizuar; krimin ekonomik; kabotazhin dhe të gjitha çështjet e tjera të cilat kanë ndikim direkt për sigurinë e Kosovës. Me një fjalë, çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj janë esenciale për popullin e Kosovës dhe vetë Kosovën.

Me këtë projektligj përcaktohet përdorimi i të gjitha mjeteve të arsyeshme dhe të ligjshme, të cilat duhet të përdoren për të siguruar që Kosova të pranojë informatat më cilësore të inteligjencës në dispozicion.

Për këtë qëllim, themelimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë garanton mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e të gjitha këtyre informatave të cekura në mënyrë të shpejtë dhe të përgjegjshme.

Parimet e parashtuara në këtë projektligj janë hartuar për të arritur një baraspeshë të duhur dhe të domosdoshme ndërmjet marrjes së informacionit esencial dhe mbrojtjes së interesave individuale – mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Me një fjalë, Projektligji është bazuar edhe në përvojat pozitive të disa vendeve me traditë demokratike institucionale dhe funksionale.

Veç kësaj, Projektligji është në pajtueshmëri me dispozitat e Kushtetutës dhe të gjitha ligjeve të tjera në fuqi.

Dispozitat e këtij projektligji respektojnë parimet e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore të Njeriut dhe parimet tjera relevante të pasqyruara në instrumentet ligjore të njohura ndërkombëtarisht dhe garanton kryerjen e aktiviteteve të Agjencisë për Inteligjencë në pajtueshmëri me to.

Presidenti i Republikës së Kosovës, së bashku me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, emërojnë drejtorin, zëvendësdrejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë.

Agjencia Kosovare për Inteligjencë, ose Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, do të ketë përbërje dhe strukturë drejtuese profesionale dhe apartiake.

AKI i nënshtrohet kontrollit parlamentar.

Agjencioni i Kosovës për Inteligjencë nxjerr rregullore për organizimin e brendshëm, si dhe do të ketë kodin e etikës.

Drejtori dhe zëvendësdrejtori do të jenë me mandat pesëvjeçar, ndërsa inspektori i përgjithshëm me mandat katërvjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër.

Të nderuar deputetë,

Ky Projektligj ka 9 kapituj, me 45 nene dhe ky ishte një prezantim me pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji kaq të rëndësishëm për vendin tonë dhe unë ju propozoj që ta miratoni, sepse duke miratuar këtë projektligj do të bëjmë hap të rëndësishëm për të rregulluar me dispozita e norma juridike këtë çështje dhe fushë me rëndësi kruciale për Kosovën dhe popullin e saj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani e kanë radhën kryetarët e grupeve parlamentare. Ftoj deputetin Ramë Buja... Atëherë, ftoj Rustem Mustafën, që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të marrë fjalën.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, zoti Kryetar! Në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës jemi pajtuar që në parim ta votojmë Projektligjin për Agjencionin e Kosovës për Inteligjencë dhe në Grupin ad-hoc do të japim edhe kontributin e duhur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Për LDK-në, fjalën e ka Sabri Hamiti. Urdhëroni, zoti Hamiti!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës! Ne kemi para veti një Ligj, që, domosdoshmërisht ka një rëndësi të jashtëzakonshme, unë do të thosha edhe më tepër – një peshë të jashtëzakonshme. Një ligj që do të formojë Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, që është një domosdo për sigurimin nacional të Kosovës dhe në të njëjtën kohë një Ligj që, për kah natyra dhe trashëgimia, për kah perceptimi që kemi ne për shërbime të tilla, duket një ligj i rrezikshëm kundër rrezikut, një Ligj që në emër të sigurisë mund edhe ta ndrydhë sigurinë individuale, ta prejë privacitetin.

Pra, kemi para vetes një ligj të domosdoshëm dhe një ligj shumë të ndjeshëm dhe, të them haptas atë që mendoj, kujtoj që nuk është mirë në princip që ligjet e tilla të kalohen kaq shpejt. E mira e së mirës do të ishte që ky ligj të studiohej dhe të diskutohej edhe në nivel parlamentar edhe në nivel të ekspertëve, më tepër.

Atë që dua ta them me këtë rast dhe në fillim është që Grupi Parlamentar i LDK-së, sot, pas leximit të shpejtë kush qysh ka arritur, megjithatë është lexuar dhe kemi marrë qëndrim që në parim do ta përkrahim Ligjin që të kalojë, me disa vërejtje, të cilat unë këtu menjëherë do t'i theksoj dhe kërkoj që t'i ketë parasysh Komisioni ad-hoc në mbledhjet që do t'i ketë, unë besoj brenda ditës së sotme.

Vërejtjet tona kanë të bëjnë me një fuqi, gati imperiale, të drejtorit të Agjencisë, i cili, me Ligjin e propozuar, është ligjvënës – ligjvënësi themelor i Agjencisë, urdhëruesi dhe zbatuesi i ligjeve dhe urdhrave që i bën vet. Ekziston një mbikëqyrjeje e projektuar parlamentare. Megjithatë, në Ligj, një kapitull i tërë i kushtohet këtij kontrolli parlamentar, që i bie civil të shërbimit, ndërsa brenda Ligjit ka një dizajnim përngushtues – përcaktues ngushtues të tipit të këtij kontrolli parlamentar.



Duke pasur parasysh që këtë që e them dua ta bëj më konkrete, sidomos për ekipin që do ta rishqyrtojë – ekipin ad-hoc, i kam katër nene që po i sugjeroj:

Neni 29, që është nen, unë do të them, i rrezikshëm, siç është tash për tash i formuar, sepse mund të bëhet me urdhër për përgjim emergjent pa iu drejtuar as gjykatës. Hiq, as Gjykatës së Lartë, që mund të bëhet e të kthehet në arbitraritet.

Neni 32, në të cilin, me një urdhër të drejtorit, Agjencia përjashtohet, do të jetë i përjashtuar nga dispozitat e çfarëdo ligji në fuqi. Prapë, është nen që duhet të rishqyrtohet.

Neni 42, që ka të bëjë me urdhrin për shpenzimet emergjente, të cilat mund të kryhen çdo kohë dhe në çfarëdo madhësie, me një informacion pas asaj.

Dhe, neni 35, që ka të bëjë me tipin e mbikëqyrjes parlamentare, që e thashë edhe njëherë, mua më duket se nuk duhet të dizajnohet brenda këtij ligji në këtë formë, sepse çështja e kontrollit, mbikëqyrjes parlamentare është çështje e Kuvendit të Kosovës dhe në Kuvend të Kosovës përcaktohen detyrat themelore, pa marrë parasysh se kemi të bëjmë me një shërbim të sojit të veçantë.

Dhe, në fund, unë uroj dhe kërkoj që në krye të këtij shërbimi të vijnë përnjëmend njerëzit apartiak, sepse me këtë ligj, si është tash dhe me një ngjyrim ekskluziviteti partizan – partiak, në këtë shërbim mund të hyjë arbitrariteti. Hyrja e arbitraritetit në një shërbim të tillë, pastaj mund të degjenerojë në shkeljen e të drejtave, në vend që të jetë mbrojtje e të drejtave individuale dhe e sigurisë në Kosovë.

Këto ishin vërejtjet konkrete që unë i artikulova, por janë vërejtje në të vërtetë të Grupit Parlamentar të LDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Për hir të opinionit, dua të sqaroj që grupi punues i këtyre ligjeve është një grup i tranzicionit, ku marrin pjesë përfaqësues të partive politike të pozitës dhe të opozitës, të administratës së UNMIK-ut, të administratës së re të BE-së dhe të ekspertëve të tjerë. Në një mënyrë janë ligje që janë punuar nga ekspertë të shumtë dhe, natyrisht, mendoj edhe deri më tani partitë politike kanë pasur mundësi të inkorporojnë kërkesat e tyre dhe sigurisht do të kenë mundësi edhe përmes përfaqësuesve të tyre në Grupin ad-hoc.

Radhën e ka Grupi Parlamentar i AKR-së, por mungon. Atëherë, fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot është një ditë e veçantë në Kuvendin e Kosovës, sepse para nesh është një ligj për një mekanizëm të sigurisë, kisha për të thënë, thelbësor për një shtet, për një mekanizëm aq

shumë të domosdoshëm për Kosovën, duke marrë parasysh fazën e zhvillimit të shoqërisë sonë dhe fazën e ndërtimit dhe të zhvillimit të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ky ligj është punuar më së paku që 3 vite dhe në të kanë marrë pjesë ekspertë të lëmive më të ndryshme, prej asaj juridike e të sigurisë të Kosovës dhe të miqve tanë.

Shfrytëzoj rastin që nga kjo foltore t'i falënderoj të gjithë ata që na ndihmuan që para nesh të vjen ky ligj.

Ligji që është para nesh, të nderuar deputetë, është për një agjencion apo shërbim të avancuar dhe për një shtet të ndërtuar mirë. Me implementimin e këtij ligji, si institucione të Kosovës, Kuvend dhe parti politike, duhet të jemi shumë të kujdesshëm, të vëmendshëm për ta ndërtuar vërtet një agjencion, i cili do të jetë jashtë ndikimit të partive politike dhe jashtë ndikimit të politikës. Do të jetë, pra, një agjencion që do të kryejë vërtet punën ashtu siç është e përcaktuar me ligj.

Unë pajtoj me shumë vërejtje që i dha parafolësi im, por duhet të kemi parasysh se ndërtimi i një mekanizmi të tillë do të kërkojë edhe shumë vendime dhe ligje plotësuese që duhet të miratohen në këtë Kuvend.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK, të nderuar deputetë, kam vetëm një vërejtje. Neni 24, paragrafi 7, kur kemi të bëjmë me burimet e informacionit, citoj kur thotë: “në kryerjen e detyrave dhe të përgjegjësisë të veta AKI-a mund” dhe nën 7: “të caktojë punonjës të AKI-së të punojnë në fshehtësi në institucione apo organe të Kosovës”. Kompetencat e këtij Agjencioni, të nderuar deputetë, me këtë ligj janë që edhe brenda Qeverisë, brenda Kabinetit të Kryeministrit, Presidentit, pra të institucioneve, brenda Shërbimit Policor të Kosovës, Forcës së Sigurisë së Kosovës, përfaqësive diplomatike të rekrutojë punonjës që në fshehtësi punojnë për Agjencinë.

Nuk jam kundër këtij paragrafi, porse këtë paragraf dhe këtë mundësi me ligj e kanë të gjitha shërbimet e avancuara të shteteve që kanë traditë 100-vjeçare, 200 e 400-vjeçare. Duhet të kemi kujdes shumë në implementimin e këtij ligji dhe posaçërisht të këtij paragrafi.

Sa i përket përcaktimit me këtë projektligj se si duhet bërë kontrolli parlamentar, edhe kur Partia ime ka qenë pozitive, në emër të AAK-së kam luftuar që të përcaktohet me ligj që kryesuesi i Komisionit parlamentar që do të duhet të ndërtohet i veçantë për kontrollin mbi këtë Agjencion, të udhëhiqet nga partia e cila nuk përfaqësohet në pozitive për shkak të balancit që duhet të krijohet me mbifuqinë e këtij Agjencioni. Pra, në qoftë se me Kushtetutë, që edhe aty kam pasur vërejtje, zoti Kryetar sikur që e dini, që kryetari dhe kryeministri nominojnë dhe emërojnë drejtorin, zëvendësdrejtorin dhe inspektorin e përgjithshëm, e jo nga koalicioni qeveritar nga pozita, atëherë kontrollin parlamentar mbi Agjencionin dhe mbi këtë duhet ta ketë opozita dhe atë edhe me fuqinë e votës brenda Komisionit parlamentar, pra për një votë më shumë se sa partitë politike ose anëtarët e Komisionit që vijnë nga grupet parlamentare që janë në pozitive.

Mendoj se kështu duhet të ndërtohet një balans mbi këtë agjencion, i cili do të na shkaktojë dhe ka për të na shkaktuar mjaft kokëçarje këtu dhe probleme se duhet të mbahet ndërtimi i këtij Agjencioni nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kuvendit dhe të institucioneve të Kosovës.

Në fund, zoti Kryetar, më lejoni që, duke i dhënë mbështetje të plotë dhe duke përjetuar këtë ditë si të veçantë për Kosovën dhe për Kuvendin e Kosovës, në emër të Grupit Parlamentar edhe njëherë t'i ftoj miqtë tanë që na ndihmuan të vijmë deri këtu dhe që edhe në të ardhmen të na ndihmojnë në ndërtimin e një agjencioni vërtet ashtu siç e meritojmë dhe të një agjencioni i cili do të jetë i pavarur dhe në shërbim të interesave të shtetit të Kosovës. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, kryetari Lulzim Zeneli.

**LULZIM ZENELI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Deputeti paraparak dha shumë sqarime sa i përket këtij projektligji, për të cilin është dashur që ta marrë një rrugë tjetër të trajtimit për faktin se ka një rëndësi shumë të madhe dhe përcakton një pjesë të madhe të ecjes apo të rrugës së shoqërisë sonë drejt krijimit të një standardi që të gjithë po pretendojmë.

Ajo çka duhet të theksohet, në kuadër të këtij ligji, apo të këtij projektligji, që është një mangësi dhe do ta përcjellë edhe në ecje më tutje, është paqartësia juridike në kompetenca të cilat krijohen në mes të dy institucioneve të vendit – Kryetarit të vendit dhe Kryeministrit. Dhe, kjo paqartësi, mund të krijojë një vakum, i cili, në ecjen tonë si shtet, mund të nxjerrë telashe të mëdha.

Ajo çka duhet theksuar është se ky projektligj, edhe mbi bazën e krejt shqetësimeve që rrjedhin kur diskutojmë për këtë projekt, nuk garanton apolitizmin e këtij mekanizmi. Pra, me plot të drejtë thirremi në atë që të gjitha këto megakompetenca, të cilat adresohen në kuadër të udhëheqësit të këtij mekanizmi, të këtij Agjencioni, në anën tjetër nuk garanton kontroll parlamentar, një kontroll demokratik për të cilin ekziston mëdyshja se nesër në cilin rrugëtim do të jemi në këtë fazë.

Ajo çka mund të thuhet në këtë rast se pse është aq i rëndësishëm për ne, është fakti se po ndërtojmë dhe jemi në fazën kur duhet të tregojmë vullnetin maksimal për të ndërtuar një shoqëri mbi bazën e një demokracie që ekziston dhe funksionon në shtetet demokratike.

Prandaj, duke e përkrahur në parim, ne të gjitha vërejtjet tona do t'i adresojmë në Komisionin ad-hoc. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputeti, që është edhe anëtar i Kryesisë, Xhezair Murati.

XHEZAI R MURATI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Hvala i pozdravljam vas, Premijera, zamenike, ministre i kolege,

I ja spadam u grupu onih izlagača koji smatraju da ovaj zakon u odnosu na sve koje smo usvajali i koje treba da usvajamo, ima specifičnost i veliku specifičnost za Kosovo kao mlada država, koja je bila u jednoj dužoj fazi, kao što znate, političkog, ekonomskog i svakog drugog razvoja, u fazi u kojoj su mnogi iz okruženja i iz nekog šireg okruženja u svakom slučaju ubacili ljude koji su radili za interese tih zemalja a možda i protiv interesa Kosova i tako dalje, tako da će ova oblast zahtevati, što je rekao i jedan od kolega, možda i vreme sa kojim treba da raspolažemo, kako bi smo neke stvari mogli da ovde na jedan parlamentaran način primetimo i dogradimo, ali na drugoj strani smo suočeni sa vremenskim ograničenjima koje nam nameće Paket Ahtisarija.

Ovaj zakon zadire u privatnost ali i štiti privatnost. Opet su to dve suprotnosti. Ovaj zakon omogućava državi kontrolu fiksne i mobilne telefonije i svih nekih radnji koje mogu uticati i podrivati jedno društvo, jednu državu a i na drugoj strani radi se o državi koja nije zaokružila svoju teritorijalnu celokupnost.

Dekle, mi smo zaista suočeni sa velikim izazovima pa će, nadamo se, ovaj zakon da nam pruži u svakom slučaju pomoć u poslovima koji su pred nama oko zaokruživanja državnosti i tako dalje.

Finansijska potpora zakona je nejasna, s obzirom na čitavu oblast koju reguliše ovaj zakon, tako da će trebati što pre da dodje do informacija iz nadležnog ministarstva oko troškova koje trebamo izdvojiti jer u savremenim društvima ratovi se vode tajnim putem. E, ova agencija će biti jedino oružje države Kosova da se suprostavlja takvim pokušajima podrivanja društva i države. Znači, radi se zaista o tome da li imamo dovoljno kadrova i kako školovati kadrove. Ko nam treba pomoći sa strane a da to ne bude na štetu interesa Kosova i tako dalje, i tako dalje.

U svakom slučaju, Parlamentarna grupa „7+“, u okviru svojih mogućnosti i sposobnosti imamo želju da damo doprinos da ovaj zakon zaživi i mi ćemo preko našeg člana u Ad-hoc komisiji dati svoj doprinos i na svaki drugi mogući način, tako da u načelu prihvatamo i mislimo da se radi o solidnoj osnovi za izradu ovog zakona. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Vezano za ovaj zakon, mogu da kažem da će Samostalna liberalna stranka, tojest Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke, u načelu podržati ulazak jednog ovakavog zakona u skupštinsku proceduru. Međutim, oko ovoga postoje velike priče. Čujem ih i u Parlamentu a i čujem i svakod dana na ulici, od jednog zakona koji je neophodan da se usvoji i koji sam po sebi postoji, znači neće se desiti ništa novo. Ne formiramo nešto novo što već ne postoji, kad dva čoveka komuniciraju između sebe i razmenjuju informacije jedan o drugome. Znači, u svakom slučaju mnogo je bolje usvojiti zakon nego imati neuredjenu tu oblast.

S treće strane, pričamo priče kako ćemo uspeti da uspostavimo neku apsolutnu kontrolu nad tim. Moramo da budemo svesni da od toga ne možemo da gradimo neku svoju političku budućnost i karijeru, jer to nećemo nikad uspeti u potpunosti. Ne Kosovo, nego to ne uspevaju ni mnogo razvijenije države, zbog toga što ne možete i nemate stvarni mehanizam, osim upravo te obaveštajne službe koja će da se bavi sama sobom i da li neko predstavlja političko ili nepolitičko profesionalno lice u toj službi.

Jedno od stvari jeste da je zakon bitan, međutim nije od krucijalnog značaja za sve ljude koji žive na Kosovu. Ima mnogo bitnih zakona koji će doneti boljitak ljudima i trebamo da pričamo malo više o tome. Ova oblast jeste bitna, međutim ja se nadam da će određenim podzakonskim aktima, jer shvatamo specifičnost i specijalizovanost ove agencije, da u samom zakonu nije moglo da dodje do toga da se jasno vidi ko i kakav će uticaj imati pripadnici određenih manjinskih zajednica u ovom zakonu, tako da očekujemo od Vlade da će se u podzakonskim aktima u budućem periodu regulisati i to pitanje. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Pasi përfunduan deklarimet e shefave të grupeve parlamentare, kalojmë në procedurën e votimit.

Në sallë janë të pranishëm 86 deputetë.  
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 78 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime – Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’i paraqet Kuvendit raportin me rekomandime.

Pika e tretë e rendit të ditës është:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 19 maj 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim, konform Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI RAMË MANAJ: I nderuari Kryetar,  
Të nderuar deputetë dhe ministra,  
Duke shqyrtuar për miratim, në parim, Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, më lejoni të them se ky projektligj është paraparë në planin e Presidentit Ahtisari.

Kjo lëmi, deri më tani është rregulluar, siç dihet, me Rregulloren e UNMIK-ut numër 2002/12 - rregullore mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Përcaktimi i statusit, ka kërkuar edhe nxjerrjen e ligjit të ri. Projektligji për Agjencinë Kosovare të privatizimit, është teksti i harmonizuar ndërmjet Grupit politik gjithëpërfshirës, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar dhe Bashkësisë Evropiane.

Qëllimi, respektivisht objektivat e Ligjit të ri janë: zbatimi i dispozitave të shtojcës shtatë të Propozimit për zgjidhjen e statusit, të cilat kërkojnë ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit ekzistues në Kosovë për privatizimin; zëvendësimin e Rregullorës së UNMIK-ut për Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit me një ligj të ri, korrigjimin e disa mangësive që kishte kjo rregullore, zëvendësimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit me një institucion të ri pasardhës, pra me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Autorizimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për privatizimin e ndërmarrjeve të mbetura në pronësi shoqërore ende të paprivatizuara, në mënyrë efektive dhe në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç kërkohet nga Kushtetuta e re dhe propozimi për zgjidhjen e statusit.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, ajo ekzistuesja, shpërbëhen formalisht dhe juridikisht dhe zëvendësohet me institucionin e ri pasardhës, pra me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

AKM-ja do të shndërrohet në AKP edhe në kuptim të shkurtesave dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj do t'i marrë përsipër Agjencioni Kosovar i Privatizimit. Prandaj, në përjashtim të disa ndryshimeve në personel, tranzicioni do të jetë i lehtë dhe Agjencioni Kosovar i Privatizimit do të vazhdojë punën që aktualisht kryhet nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit.

Struktura dhe përmbajta e ligjit të ri është e ngjashme me Rregulloren e AKM-së, megjithatë ligji i ri përmban disa ndryshime përmbajtësore të cilat janë bërë me qëllim që së pari të jetë në përputhje me zgjidhjen e statusit final të Kosovë dhe që Agjencioni Kosovar i Privatizimit të ketë bazë të fuqishme juridike gjatë zhvillimit të aktiviteteve të privatizimit.

Projektligji ka 7 kapituj dhe 32 nene. Kapitulli i parë rregullon statusin ligjor, qëllimet dhe përkufizimet, i dyti rregullon detyrat dhe kompetencat e agjencisë, i tretë rregullon organizimin dhe menaxhimin, i katërti rregullon dispozitat financiare, i pestë rregullon përgjegjësinë dhe komisionet shqyrtuese, i gjashtë rregullon zbatimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kapitulli i shtatë- i fundit, rregullon dispozitat përfundimtare.

Nuk ekzistojnë direktivat e Bashkimit Evropian, të cilat i rregullojnë çështjen e privatizimit në vendet anëtare. Ligji është në harmoni të plotë me kërkesat themelore të BE-së për transparencën dhe jodiskriminimin.

Në fund ju kërkoj që ta miratoni në parim këtë projektligj.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Sipas radhës- Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kryetari i Grupit, Ramë Buja.

RAMË BUJA: Se pari, ne si Grup Parlamentar urojmë që kjo agjenci të shndërrohet në Agjencion Kosovar të Privatizimit, sepse ishte e Mirëbesimit dhe në fakt ishte e kundërta e vetvetes, këtë e përshëndesim dhe natyrisht që e mbështesim këtë projektligj në parim, duke shfrytëzuar të drejtën tonë që, në grupin ad-hoc t'i bëjmë vërejtjet tona.

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI. Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Duke ju përshëndetur të gjithë të pranishmit, po ashtu Grupi Parlamentar i LDK-së, shqyrtoi sot paradite dhe në bazë të opinioneve dhe mendimit të tyre është vlerësimi që të përkrahet në parim ky Projektligj për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili do të bëjë pra administrimin, privatizimin dhe rikordin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore.

Është një tranzicion i nevojshëm, i cili do të mundësohet përmes këtij projektligji që kompetencat të barten tek institucionet vendore dhe besojmë që edhe Parlamentit, përmes emërimit u ka lënë hapësirë dhe mundësi që ta zgjedhë bordin që do ta drejtojë këtë agjenci me shumë rëndësi për vendin dhe për ekonominë e vendit, prandaj ne e përkrahim në parim.

Unë personalisht po e shprehi një mendim timin, po e shfrytëzoj këtë të drejtë, lidhur me financimin, le të shqyrtojë Komisioni ad-hoc a duhet të financohet, bie fjala, e tërë veprimtaria e këtij agjencioni nga buxheti i Kosovës, apo të shihet mundësia e participimit nga Fondi i privatizimit, në mënyrë që të shpenzohen mjete më pak nga buxheti i Kosovës. Një sugjerim, do të thotë, nga ana ime si deputet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, mungon.

Në emër të Kryetarit i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI, Ju faleminderit, zoti kryetar. Njëjtë sikur kolegët më përpara, e mbështesim në parim miratimin e këtij ligji dhe do të shohim nëse kemi mundësi ta bëjmë ndonjë përmirësim në Komisionin ad-hoc Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, zoti Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Edhe ne në parim, në fakt e mbështesim hartimin e këtij ligji për Agjencionin Kosovar të Privatizimit, mirëpo, edhe pse ne do të ndërhyjmë në Komisionin ad-hoc me qëllim të përmirësimit, respektivisht ngritjes së cilësisë së këtij ligji, nuk ishim pajtuar se transformimi është bërë komplet nga Agjencioni i Mirëbesimit në një Agjencion Kosovar. Kur e them këtë, e argumentoj me këto pika të ligjit, të cilat në njëfarë forme lejojnë hapësirë apo partneritet me faktorët e tjerë që, në fakt, çështja e privatizimit, menaxhimit të ndërmarrjeve publike dhe shoqërore dhe likuidimi i tyre, nuk është krejt në kompetencat qoftë të Qeverisë apo të organeve tona si organe vendore. Kjo shihet në përbërjen e Bordit, neni 12, pika 12.2, ku thotë: “Bordi përbëhet prej 8 anëtarëve, 4 prej tyre propozohen nga Kuvendi”. Në fakt, nuk i propozon Kuvendi 4, sepse njëri prej tyre është kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, do me thënë tre anëtarë i mbeten Kuvendit të Kosovës si përfaqësues në Bord.

Mandej, çka është ajo më e rëndësishme, shihet në nenin 14. pika 14.7, vërtet 14.9, ku thuhet se anëtarët ndërkombëtarë të Bordit, në mënyrë të përbashkët, do me thënë pjesa që përfaqësohet nga anëtarët ndërkombëtarë, janë tre. Mirëpo, thotë, tre anëtarë ndërkombëtarë të Bordit, në mënyrë të përbashkët dhe unanime mund të pezullojnë cilindo vendim të marrë nga Bordi. Çka do të thotë, nuk është transformim i plotë i AKM në një bord të privatizimit si Agjencion Kosovar i Privatizimit, por ende mbeten shumë kompetenca të rezervuara nga partnerët ndërkombëtarë dhe shpresoj që shumë fenomene do të jenë jofunksionale në aspektin e zhvillimit të partnerizimit, ashtu si është reflektuar deri tani. Shpresoj që këto dhe shumë çështje tjera edhe anëtarët tjerë në Komision do t’i përmirësojmë dhe shpresojmë se do të kemi një ligj të mirë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Është një transformim i koordinuar. Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Poashtu Grupi „ 7+“, pajtohet që ky Ligj të kalojë, mirëpo sigurisht në Komision do të përmbushet me këtë që e thanë kolegët e mi para meje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsjedniče! Ovoga puta ne bih želeo puno da komentarišem ovaj Nacrt zakona. Rečiću da čemo ga mi podržati u načelu, međjutim nismo imali dovoljno vremena da razmotrimo sve aspekte ovog zakona, s obzirom da je rok bio kratak, tako da zadržavamo pravo da u ad-hoc Komisiji, do sledećeg čitanja, to jest drugog usvajanja Zakona, možda i promenimo svoju odluku. U svakom slučaju, još jednom ponavljam, podržaćemo prvo usvajanje Nacrta zakona.

KRYETARI: Ju faleminderit!

I ftoj deputetët që të kthehen në sallë për votim.

E lus regjinë që t’i ftojë deputetët që momentalisht nuk janë në sallë. Ndoshta është mirë pas një orë e gjysme pune, ta kërkojmë një pauzë. Ju faleminderit!



Tani kemi 81 deputetë prezentë. Mund të shkojmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 74 vota “për”, 5 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t’i paraqet Kuvendit raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 19 maj 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit, të datës 15. shkurt 2008.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Zenun Pajaziti, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI, ZENUN PAJAZITI: I nderuar zotëri Kryetar!

Zotëri zëvendëskryeministër, ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni para se ta bëj një prezantim të shkurtër të këtij projektligji, t’i falënderoj të gjithë anëtarët e grupit punues, që kanë punuar në këtë projektligj. Dëshiroj të jetë ky falënderim i veçantë, sepse ka qenë pak më i vështirë se sa tjerët, gjatë kohës së draftimit të tij ka pasur edhe një përkushtim të veçantë për shkak të sjelljes së përvojave më të mira dhe adaptimin me legjislacionin e BE-së.

Projektligji adreson çështjet që kanë të bëjnë me organet kompetente që janë të ngarkuara me përgjegjësi për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror, me bashkëpunimin e policisë kufitare me agjencitë e tjera në kufi, me qëllim të sigurimit të pacenueshmërisë së kufirit, mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, parandalimin e migrimit ilegal, zbulimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale dhe arrestimin e kryerësve të tyre, ndalimin e kontrabandimit të mallrave dhe bashkëpunimi në fushën e përgjegjësi dhe të autorizimeve të organeve shtetërore, si dhe kushtet për mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e një rëndësie të madhe për faktin se e bën rregullimin ligjor të menaxhimit të integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

Ky projektligj ka tetë kapituj me gjithsej 38 nene dhe është në harmoni me legjislacionin e BE-së dhe parimet në bazë të aquis communautaire.

Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese dhe krijon stabilitet legjislativ për fushën që e rregullon. Për zbatimin e këtij projektligji, nevojiten mjete buxhetore, por edhe krijohen të hyra për buxhetin e konsoliduar të Republikës së Kosovës në vetë kohën e aplikimit të tij. Projektligji është i përgatitur në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Propozoj, për arsyet që i thashë, që ky projektligj të miratohet, në mënyrë që i njëjti të procedohet më tutje.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër. Tani e kanë radhën për të diskutuar kryetarët e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSATAFA: Ju faleminderit, i nderuari kryetar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka dhënë pëlqimin që të miratohet në parim ky ligj dhe e sheh si ligj të nevojshëm për ta demonstruar fuqinë e shtetit për kontrollin e kufijve.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Tani është radha e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetit Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputet,

Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet në parim miratimin e Ligjit për kontrollin dhe menaxhimin e kufijve të Kosovës, sepse është njëri nga ligjet e rëndësishëm në këtë fazë të procesit që po kalon Kosova. Qasjen tonë do ta kemi gjatë ditës në Grupin ad-hoc, sipas mocionit të Kuvendit dhe besojmë që angazhimi ynë do të jetë shumë pozitiv.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, mungon. Tani është radha e Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Edhe ky ligj është duke u punuar një kohë të gjatë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Departamentin përkatës dhe mendoj se është ligj i punuar mirë dhe konform standardeve ndërkombëtare. Ky ligj është bazik për shtetësinë e Kosovës dhe për kontrollin e kufijve shtetëror të Republikës së Kosovës. Prandaj, Grupi Parlamentar i AAK-së e miraton në parim këtë projektligj.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kemi dy deputetë. Cili prej jush e do fjalën? Gani Geci.

GANI GECI: Meqë nuk ishte Luli këtu, e mora unë fjalën.  
Të nderuar deputetë,  
I nderuari kryetar,  
Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë mbështet në parim Projektligjin për menaxhimin e integruar të kufijve shtetëror dhe ne besojmë për një të ardhme të shkurtër nuk do të kemi nevojë për kufij, siç nuk kanë nevojë shtet perëndimore. Vërejtjet tona do t'i japim në Komisionin ad-hoc  
Ju faleminderit!

KRKYETARI: Ju faleminderit !  
Në emër të Grupit Parlamentar “7+“, deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!  
Grupi „7+“ pajtohet që ky ligj të kalojë, mirëpo ekspertët e Komisionit ad-hoc, sigurisht do ta shohin më mirë, mirëpo një ligj i këtillë na duhet dhe besoj se sikur që tha edhe zotëriu para meje, edhe ne në Komisionin për Siguri e kemi përpunuar këtë edhe kështu si ligj është në rregull, mirëpo përsëri ekspertët e Komisionit ad hoc do ta rregullojnë. Pra, besoj se si i tillë është me vend.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet.  
Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, kryetari Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsjednice,  
Mi nismo učestvovali u izradi ovog Zakona, materijal smo dobili kasno, tako da čemo ovoga puta biti uzdržani. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!  
Tani është radha për të votuar.  
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.  
Ju njoftoj se në sallë kemi 79 deputetë. Votojmë tash.

Konstatoj se me 69 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.  
Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15. shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t’ia paraqesë Kuvendit Raportin me rekomandime.

Pika e radhës e është pika e pestë e rendit të ditës:

## **- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 19 maj 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15. shkurt 2008.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Zenun Pajaziti, që në emër të Qeverisë ta paraqes Projektligjin.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni që të bëj prezantimin e këtij projektligji, i cili përveç asaj që rregullon këtë fushë, ka një impakt të drejtpërdrejtë në këtë kohë, e sidomos edhe për fusha të tjera që janë shumë të rëndësishme për ne, për lëvizjen e qytetarëve, sidomos ka një ndikim në procesin e shpejtë që do të hymë ne, të liberalizimit të vizave.

Me qëllim të krijimit të një kornize ligjore për rregullimin e çështjeve të azilit dhe të refugjatëve në Republikën e Kosovës, kriteret e njohjes së azilit, të drejtat dhe detyrimet e refugjatëve dhe rregullimin e procedurave nga kjo lëmi, Ministria e Punëve të Brendshme ka iniciuar Projektligjin për azil në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij projektligji është vendosja e rregullave ligjore lidhur me çështjet e refugjatëve, azilkërkuesve, personave nën mbrojtje plotësuese dhe atyre nën mbrojtje të përkohshme, të cilët kërkojnë mbrojtje në Republikën e Kosovës.

Projektligji adreson çështje që kanë të bëjnë me: njohjen e azilit, ndërprerjen e tij, bashkëpunimin e organeve shtetërore me Zyrën e UNHACER-it, organet kompetente për azil, parimin e dyshkallshmërisë brenda procedurës administrative, si dhe kategoritë përfituese nga njohja e azilit.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e një rëndësie të madhe për faktin se bën rregullimin ligjor të të gjitha çështjeve që ndërlidhen me personat të cilët kërkojnë azil, përcakton afatet kohore për themelimin e Qendrës së Azilit në Kosovë dhe përshkruan në vija kryesore procedurat nga kjo lëmi.

Projektligji ka 9 kapituj me gjithsej 73 nene dhe është në harmoni me legjislacionin e BE-së. Projektligji nuk përmban elemente diskriminuese dhe krijon një stabilitet legjislativ për fushën e azilit. Për zbatimin e këtij projektligji nevojiten mjete nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës. Projektligji është i përgatitur në gjuhët zyrtare, dhe në bazë të këtyre arsyeve, propozoj që Projektligji të miratohet në mënyrë që i njëjti të vazhdojë në procedim të mëtejshëm.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministër,  
Ministra të nderuar,  
Kolegë deputetë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës konsideron se Projektligji në fjalë është i një rëndësie të veçantë, duke pasur parasysh që qytetarët e Kosovës kanë pasur fatin për shkak të përndjekjeve politike, domethënë fat në fatkeqësi, që në shumë vende të botës të kërkojnë azil apo strehim politik. Prandaj, sot është fat që ka ndryshuar statusi politik i Kosovës dhe Kosova e ka mundësinë që përmes ligjit që do ta miratojë, të krijojë rrethanat që t'u ofrojnë mbrojtje qytetarëve të cilët do të kenë nevojë që të kërkojnë mbrojtje dhe realizim të të drejtave të tyre në Republikën e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah në parim Projektligjin, kurse për vërejtjet eventuale, ne me shkrim do t'i drejtohem Komisionit ad-hoc.  
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!  
Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!  
Zëvendëskryeministër,  
Të nderuar ministra,  
Kolegë deputetë,  
Projektligji për azil rregullon një fushë shumë të rëndësishme dhe, të them të drejtën, është Projektligji më i kompletuar që na është proceduar për këtë seancë plenare. Pasi që kjo fushë ka qenë e rregulluar deri me tani me Rregulloren të UNMIK-ut mbi lëvizjen e personave brenda dhe jashtë Kosovës, që nga tani, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, rregullohen: çështja e azilit dhe e refugjatëve, kushtet, procedurat për njohjen, ndërprerjen dhe statusin dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve.

Projektligji është i mbështetur edhe në kapitullin 4, te neni 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përmban 9 kapituj e 73 nene dhe është i hartuar me përpikëri, duke u mbështetur dhe duke u zotuar për zbatimin e Konventës së vitit 1951, lidhur me statusin e refugjatit dhe dokumentet e tjera ndërkombëtare për refugjatë.

Grupi Parlamentar i LDK-së, pas shqyrtimit, edhe pse në kohë të shkurtër, e mbështet në parim këtë projektligj. Edhe pse përmban implikime buxhetore, nuk e kemi pasqyrën financiare, por shihet që do të ketë implikime jo të vogla buxhetore, ne e mbështesim edhe në procedurat e mëtutjeshme.  
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!  
Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I bashkëngjitëm edhe unë konstatimit të parafolësit se ky ligj na ka ardhur në dorë i përpunuar dhe i punuar mirë, i hartuar mirë, mirëpo më lejoni, të nderuar deputetë, që t'i jap disa vërejtje në këtë projektligj.

Vërejtjet e Grupit Parlamentar të AAK-së kanë të bëjnë kryesisht me faktin, sipas mendimit tonë, se ky ligj është tepër liberal dhe praktikisht i kthehet ligjeve të shteteve të Evropës Perëndimore gjatë kohës kur ishte lufta e ftohtë dhe perdja e hekurt.

Më lejoni që të citoj nenin 8, Hyrja në territorin e Republikës së Kosovës, paragrafi 8.1 thotë kështu, të nderuar deputetë: “ I huaji i cili deklaron qëllimin e tij/saj për parashtrimin e kërkesës për azil në Republikën e Kosovës, do të trajtohet si një azilkërkues në pajtim me këtë ligj, pra ai/ajo do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës”, që kjo lidhet direkt me nenin 26, paragrafi 4 të Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror, ku thuhet se:”në rast se është bërë kërkesë për azil, rasti do të trajtohet në përputhje me Ligjin mbi azilin”. Pse i citova këto dy nene, të nderuar deputetë?

Figurativisht, çdo person, qoftë edhe pa dokumente personale që lajmërohet në cilindo pikë kufitare të Republikës së Kosovës, qoftë në Aeroport ose në pikë kufitare tokësore dhe thotë që kërkoj azil, pra, i lejohet hyrja në territorin e Republikën së Kosovës dhe trajtimi i tij pastaj, dhe e drejta që ai të parashtrojë kërkesë dhe t'i hyjë procedurës që e trajton këtë rast dhe e përkufizon me nenin 4 deri në 7 të këtij projektligji, dhe kur e kemi parasysh paragrafin 4 të nenit 7, ku thuhet, citoj: “Organi kompetent do t'i lejojë të huajit mundësinë që të kundërshtojë dëshminë se deportimi i tij sipas nenit 7, të këtij Ligji, është ligjshëm”. Pra, hyjmë në një labirinth të trajtimit që do të zgjatë me vite dhe do të ketë kosto të madhe buxhetore për Republikën e Kosovës dhe për shtetin tonë. Pra, do të kemi raste të shumta, të cilat pastaj me vite të tëra do të kenë mundësinë e lejuar në bazë të këtyre neneve të këtij ligji të qëndrimit të tyre në shpenzimet që i heq Republika e Kosovës nga buxheti i saj. Mendoj se këtu këto nene pra janë tepër liberale dhe mendoj se do të kenë implikime, implikime të larta buxhetore.

Në parim, Grupi Parlamentar i AAK-së e miraton këtë projektligj, por shfrytëzojmë të drejtën tonë që në Grupin Ad-hoc t'i paraqesim këto vërejtje lidhur me mundësinë përmirësimit të këtyre neneve  
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, radha është e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. E ka fjalën deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar!  
Kolegë të nderuar,  
Kabinet qeveritar,

Duke pasur parasysh se edhe ashtu kufijtë e Kosovës janë cenuar dhe gëzon fakti që posa e miratuam një ligj për kontrollin e kufijve të Kosovës. Në bazë të kësaj, natyrisht që në

Kosovë hynë dhe dalin kushdo pa kontroll dhe është më se i domosdoshëm edhe ky ligj. Edhe pse në këtë ligj, vërtet, për mendimin tonë ka nevojë për të qenë ndryshe, duke pasur sidomos parasysh implikimet buxhetore që i ka ky ligj dhe duke pasur parasysh që shteti i Kosovës në këto momente po edhe në të ardhmen është i varfër dhe natyrisht që është vështirë për t'i përballuar këto implikime buxhetore.

Megjithatë, duke pasur parasysh që vërtet kemi nevojë për të rregulluar këtë lëmi me ligj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah në parim dhe mendojmë, shpresojmë se vërejtjet apo amendamentet tona mund të kyçen në këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar “7+”, kryetari i Grupit, deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po ashtu, Grupi “7+” në parim e mbështet këtë ligj. Edhe më parë Komisioni për Siguri e ka përpunuar, kështu që një ligj i tillë ka qenë i nevojshëm që ta ketë Republika e Kosovës. Por, a do të kemi harxhime, apo, jo, kjo dihet, sepse një ligj duhet ta kemi, pasi që ne jemi shtet tash. Pra, nuk duhet të mendojmë se a do të harxhojmë a jo edhe për këtë do të kemi buxhet, do ta gjejmë. Pra, ky ligj i nevojitet gjithsesi shtetit tonë, të gjitha shtetet e kanë edhe ne do ta kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, kryetari i Grupit Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Parlamentarna Grupa SLS će podržati u načelu donošenje ovog zakona. I naravno, ovo ima veze i sa Zakonom o državljanstvu, koje će osobe imati pravo do to pravo ostvare. Naravno, iz dva praktična razloga, u načelu ljudi odlučuju da traže azil, ili za to što nemaju gde drugo da odu, što treba precizno i jasno definisati, i to možda predstavlja opasnu stvar po bilo koju teritoriju.

Međutim, onaj drugi aspekt koji je i češći, je ekonomska situacija. Ja se nadam da će ovde biti takve situacije da će što više ljudi dolaziti da traže azil i da mogu da živi od buždeta Kosova, jer će moći da ih finansira onako kako mogu neke evropske zemlje, a u međuvremenu ako do toga dođe, mi ćemo lako promeniti i izmeniti ovaj Zakon. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarët e grupeve parlamentare i kanë kryer diskutimet e tyre. Radha është për votim. Në seancë janë 87 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 80 vota “për”, 3 “kundër” dhe 3 abstencione, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për azil.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008 ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Pika e gjashtë dhe e fundit, për sot, e rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 19 maj 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Arsim Bajrami që në emër të Qeverisë para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuari Kryetar i Kuvendit,  
Zoti Kryeministër,  
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për festat zyrtare është një ligj organik i cili mëton të krijojë bazën ligjore për rregullimin e festimit të festave zyrtare, duke qenë që deri më tani nuk ka pasur një ligj që rregullon këtë materie dhe kjo materie është rregulluar me një akt nënligjor.

Projektligji është kualifikuar si ligj që del nga Pakoja e Ahtisarit dhe iu ka nënshtruar procesit gjithëpërfshirës të miratimit, duke përfshirë fazat dhe procedurat e veçanta që po ndjek Kuvendi i Kosovës për miratimin e këtyre ligjeve.

Ministria e Shërbimeve Publike një kohë të gjatë ka punuar në këtë projektligj dhe në versionin tonë zyrtar ne e kemi propozuar një numër më të madh të festave zyrtare, duke përfshirë edhe 28 Nëntorin, 5 Marsin dhe një varg festash të tjera dhe i kemi proceduar këtë projektligj Grupit gjithëpërfshirës, për miratim dhe për shqyrtim.

Grupi gjithëpërfshirës, siç e dini, është një grup që është formuar për të miratuar ligjet e pakos të Ahtisarit dhe është i përfaqësuar nga autoritetet ndërkombëtare, nga partitë politike pozitive dhe opozitare dhe atje është diskutuar. Ligji në fakt parasheh tre lloj festash zyrtare në Republikën e Kosovës: festat zyrtare, festat kombëtare apo memoriale dhe festat komunale.

Ligji liston festat zyrtare duke përfshirë dy datat historike të popullit të Kosovës, datën e 17 shkurtit - Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ditën e miratimit të Kushtetutës dhe festat zyrtare ndërkombëtare, duke përfshirë edhe festat fetare.

Ligji në nenin 5 parasheh që Qeveria e Kosovës do të formojë Komisionin Republikan të Festave, i cili komision do të përcaktojë interiaren dhe mënyrën e festimit të festave.

Gjithashtu, ligji autorizon Qeverinë që me një vendim të veçantë të përcaktojë festat memoriale dhe kombëtare dhe të përcaktojë mënyrën e festimit të tyre.



Me këtë rast dëshiroj t'i heqë dyshimet dhe spekulimet e mediave se gjëja 28 nëntori nuk do të jetë festë. Qeveria e Kosovës, me një vendim të veçantë që do ta bie menjëherë edhe në implementim të Ligjit do të përcaktojë festat kombëtare dhe festat memoriale dhe mënyrën e festimit dhe pa dyshim festa e 28 nëntorit është një festë kombëtare që do të festohet nga i tërë kombi shqiptar. Ndërkaq, ligji përcakton festat shtetërore duke qenë se Kosova ka krijuar një identitet shtetëror dhe ka identitetin e pakontestueshëm kombëtar.

Gjithashtu, ligji përcakton edhe festat komunale dhe autorizon kuvendet e komunave që me aktet e tyre nënligjore të përcaktojnë festat komunale dhe të përcaktojnë mënyrën e festimit të tyre.

Në pjesën teknike Ligji tregon mënyrën e festimit të festave dhe përcakton ditët e pushimit, ditët e kremtimit, duke përcaktuar edhe kompensimin me pagesë gjatë ditëve të festave, por edhe duke u obliguar që shërbimet emergjente edhe gjatë ditëve të festave të punojnë.

Ne do t'i respektojmë konkluzionet dhe rekomandimet e Komisionit që është formuar për të shqyrtuar këto ligje dhe konform atyre propozimeve, ne do të mbështesim propozimet që vinë nga deputetët.

Ligji është plotësisht me standardet që kërkohen, do me thënë, është hartuar në standardet e nevojshme legjislative dhe është i përkthyer në tri gjuhët zyrtare. Propozoj që ta shqyrtoni dhe ta miratoni këtë ligj.

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti ministër!

Radha është e shefave të grupeve parlamentare. Konsideroj se grupet parlamentare janë marrë vesh sot edhe për këtë çështje. Ftoj shefin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Ramë Buja.

**RAMË BUJA:** I nderuari zoti Kryetar,  
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,  
Kolegë deputetë,

Projektligji që, natyrisht, më së shumti ka provokuar qëndrimin tonë është ky dhe ne e kemi parë për këtë kohë shumë të shkurtër si Grup parlamentar dhe, natyrisht, më së shumti kemi vërejtë në te. Këtë projektligj kemi vendosur ta përkrahim, në parim, vetëm me mundësinë që besoj është ekzistente, që të shtohen apo të amendohet ky ligj me tri data, që janë: Dita e Flamurit Kombëtar, Dita e Çlirimit dhe Dita e Dëshmorëve. Ne do ta mbështesim edhe në leximin e dytë, nëse ky ligj, në bazë të këtyre amendamenteve që do të jenë të shtuara nga Grupi Parlamentar i PDK-së, do të plotësohet, në të kundërtën do të jemi të rezervuar.

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

**SABRI HAMITI:** Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Përshëndetje për Kryeministrin dhe ekipin e tij,  
Kolegë të nderuar,

Në princip, nuk kemi si të mos e përkrahim një ligji i cili kodifikon festat zyrtare të Republikës së Kosovës. Propozuesi, në emër të propozuesit, Arsim Bajrami, ministër, dha disa shpjegime për mënyrën e hartimit dhe variacionet, por ne nuk kemi pse të hymë në histori, sepse ne duhet të bisedojmë për tekstin që e kemi përpara.

Më së pari, mendoj që titulli nuk është mirë. Nuk duhet të thuhet: “Festat zyrtare në Republikën e Kosovës”, por duhet: “Festat zyrtare të Republikës së Kosovës” dhe këtu formulimi ka dallim esencial. I gjithë ky ligj, që ka 9 nene, në të vërtetë, e ka një themelor- ky është neni 2 dhe unë po kërkoj ta lexoj të tërin.

2.1 Duke pasur parasysh respektimin e historisë, të kulturës dhe të traditave të popullit të Kosovës dhe të shtetasve të saj, festa zyrtare në Republikën e Kosovës janë:

1. Viti i Ri,
2. Dita e Pavarësisë të Republikës së Kosovës,
3. Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
4. Dita Ndërkombëtare e Punës,
5. Dita e Evropës,
6. Bajrami i Madh,
7. Bajrami i Vogël,
8. Krishtlindjet Katolike,
9. Krishtlindjet Ortodokse,
10. Pashkët Katolike, dhe
11. Pashkët Ortodokse.

Unë dua që, qoftë në kuptimin konstitucional dhe kuptimor, këto festa të cilat po numërohen këtu, bile të kenë një derivim sadopak me nenin 2.1, në pjesën e parë, domethënë që të kenë parasysh: traditën, historinë dhe kulturën e popullit të Kosovës. Me këtë strukturë të festave që kemi ne këtu, ne kemi tri festa ndërkombëtare që janë: Viti i Ri, Dita e Proletarëve edhe Dita e Evropës, kemi 6 festa fetare, ku janë 2 bajramët e islamikëve, myslimanëve dhe ku i kemi 2 krishtlindje të variantit ortodoks- katolik dhe 2 pashkët e 2 varianteve të krishtenizmit dhe çka po mbeten? Mbeten të evidentuara 2 festa që quhen edhe kulturë, edhe histori, edhe traditë, të cilat janë shumë të tashme, domethënë kemi këto që i kemi përjetuar na vetë, se jem protagonistë, na e kënda historinë ta krijojmë vetë, edhe këto të dyja i kemi. Domethënë, unë pajtohem që të jetë festë nacionale e Kosovës Dita e Pavarësisë. Mendoj që Dita e Kushtetutës nuk ka pse të jetë festë, sepse ka pasur kushtetuta këtu të Republikës së Kosovës edhe më herët që janë festuar tradicionalisht, por s’janë. Mendoj që atë variant nuk kemi pse ta bëjmë festë nacionale ditën kur është miratuar një kushtetutë, një variant. Po, unë pajtohem plotësisht me kolegun e Partisë Demokratike të Kosovës që këtu duhet të propozohen 3 data të tjera: Dita e Lirisë së Kosovës, që duhet të jetë 12 qershori, Dita e të Rënëve që nuk propozoj datë, sepse ka variante të tjera, dhe Dita e Flamurit shqiptar, që është 28 Nëntori. Këto nuk janë mendime të mia, por mendime të Grupit Parlamentar të LDK-së në mbledhjen e sotme, para se të vijmë në këtë mbledhje.

Pra, unë jam i trimëruar që në këtë pikë ne e kemi të njëjtin mendim me Partinë Demokratike të Kosovës, sepse fundi i fundit, po shihet që është edhe logjika e kërkesave të nenit 2.1. që prodhon këto data.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, mungon. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i Grupit, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se dy parafolësit e shterën pjesën e diskutimit, do të ju bashkëngjitem. Po ashtu, do t'i bashkëngjitem mendimit se duhet të diskutojmë a duhet të jetë Dita e Kushtetutës festë kombëtare? Në të njëjtën kohë mendoj se duhet të shtohen edhe dy data të tjera dhe komenti i fundit është se kur shpallen festat kombëtare, Qeveria nuk guxon t'i shpall ato, por duhet t'i shpallë Kuvendi. Nuk guxon Qeveria që të vendosë se cilat janë festat kombëtare, siç e propozoi ministri, duhet Kuvendi dhe mendoj nëse do të ketë ndonjë ndryshim në të ardhmen, atëherë ky ligj duhet ta parasheh që Qeveria e Kosovës i propozon Kuvendit dhe Kuvendi merr vendim për festat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për hir të vërtetës, dua të them se ligjet nuk janë të Qeverisë, ligjet janë të Grupit të Tranzicionit, Qeveria e ka për obligim t'i procedojë në Kuvend. Ju lutem, unë jam i obliguar ta them atë që është. Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pas deklarimeve të grupeve parlamentare, sidomos të PDK-së dhe LDK-së, nuk na mbetet shumë si opozitë, përveç se mosinkorporimi i këtyre 3 datave tjera që janë të rëndësishme, më shumë sesa që u theksua deri më tash., atëherë konsiderojmë që këto qëndrime që janë shprehur përmes pozitës në këtë Kuvend do të jenë qëndrime që do të mbahen edhe nesër.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po ju e dini që në Grupin ad-hoc të gjitha grupet parlamentare i kanë përfaqësuesit e vet. Në emër të Grupit Parlamentar të "7+" deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar "7+" në parim e përkrah këtë projektligj me të cilin përcaktohen festat zyrtare të Republikës së Kosovës, por kontributin dhe vërejtjet lidhur me komunitetet do t'i japim në Komisionin ad-hoc. Faleminderi!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poslanički klub Samosltalne liberalne strane će podržati ovakav tekst Zakona o državnim praznicima, sa jednom primedbom vezano za pravoslavni božić. Nije mi jasno da li će biti jedan dan ili dva dana s obzirom da 6-tog nije božić ili možda je neko zaboravio da ubaci 7-mi ili da zamenimo datime, u mesto 6-tog, 7-mi. Naravno, ovakav tekst ćemo podržati ukoliko bude došlo na nekih izmena i ubacivanja nekih datuma moraćemo naknadno da razmatrimo i to pa ćemo svoju odluku doneti naknadno. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Diskutimet e shefave të grupeve kanë përfunduar. Është koha për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 6 “kundër” dhe 14 abstenime, ligji miratohet.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’ia paraqesë Kuvendit Raportin me rekomandime.

Të nderuar deputetë, me kaq seancën e deklaroj të mbyllur. Mirupafshim në seancën e radhës që do të mbahet më 21 maj 2008, në orën 14,00.

Përgatiti:

**Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës**